UDHËZIM
Nr. 17, datë 30.8.2016

MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 618, DATË 7.9.2006, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË DOKUMENTACIONIT DHE MASËS SË PËRFITIMIT TË PAGESËS PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR", TË NDRYSHUAR

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", i ndryshuar, të pikës 27, të vendimit nr. 618, datë 7.9.2006, "Për përcaktimin e kritereve të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar", i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në nenin 8, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 618, datë 7.9.2006, të ndryshuar, bëhet 10.140 (dhjetë mijë e njëqind e dyzetë) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 1 të vendimit. Të njëjtën masë përfiton edhe kujdestari i personit me aftësi të kufizuar.
2. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në nenin 8, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 618, datë 7.9.2006, të ndryshuar, bëhet 10.140 (dhjetë mijë e njëqind e dyzetë) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2 të vendimit dhe 10.650 (dhjetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë në muaj për kujdestarin.
3. Efektet financiare, për zbatimin e këtij udhëzimi, fillojnë nga 1 shtatori i vitit 2016 dhe përballohen me fondet e akorduara për vitin 2016, për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.
4. Udhëzimi nr. 22, datë 20.8.2015, i ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga 1.9.2016.

MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË
Blendi Klosi